



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Datë: 26.6.2023

Nr: 671

Ora: 14:00

VENDIM  
PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË ELBASAN, QARKU ELBASAN, Z. GLEDIAN ILJAZ LLATJA, TË PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 26.6.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

**OBJEKT:** Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, Qarku Elbasan, z. Gledian Iljaz Llatja, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, dhe neni 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendor përkatëse.

Datë: 26.6.2023 Nr: 671  
Ora: 14:00



"Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, Qarku Elbasan, z. Gledian Iljaz Llatja, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin me nr. 539, datë 20.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Kryetarin e Bashkisë dhe Këshillin e Bashkisë Elbasan.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin me nr. 635, datë 26.5.2023 ka korrigjuar gabimin material në vendimin nr. 539, datë 20.5.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar Bashkie dhe për Këshillin Bashkiak, zona zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023”.

Kundër vendimit me nr. 539, datë 20.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, u administrua kërkesa ankimore nr. 85, datë 24.5.2023, me ankues koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt: Kundërshtimin e vendimit nr. 539, datë 20.5.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023” dhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Elbasan.

*Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në seancën e shqyrtimit, më datë 8.6.2023, ora 13:15 vendosi:*

- 1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 85, datë 24.5.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.*
- 2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 539, datë 20.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.*

Kundër këtij vendimi, ka paraqitur ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Me Vendimin nr. 32, datë 20.6.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi: rrëzimin e kërkesë padisë.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Datë: 26.6.2023 Nr: 671  
Ora: 14:00



Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, Qarku Elbasan, z. Gledian Iljaz Llatja, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

## VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, Qarku Elbasan, z. Gledian Iljaz Llatja, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**